



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0036

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së OE LevelMax L.L.C., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rregullimi i varrezave të martirëve dhe dëshmoreve në fshatin Makovc-Ritender” me numër të prokurimit 616-24-12647-5-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, më 13.03.2025, mori këtë:

Vendim

- Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE LevelMax L.L.C., me nr. 2025/0036, e datës 10.01.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rregullimi i varrezave të martirëve dhe dëshmoreve në fshatin Makovc-Ritender” me numër të prokurimit 616-24-12647-5-2-1,.
- Anulohet në tërësi** aktiviteti i prokurimit “Rregullimi i varrezave të martirëve dhe dëshmoreve në fshatin Makovc-Ritender” me numër të prokurimit 616-24-12647-5-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “Rregullimi i varrezave të martirëve dhe dëshmoreve në fshatin Makovc-Ritender” me numër të prokurimit 616-24-12647-5-2-1.
- Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mosrespektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik në Kosovë.
- Lejohet të bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 29.11.2024 KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rregullimi i varrezave të martirëve dhe dëshmoreve në fshatin Makovc-Ritender” me numër të prokurimit 616-24-12647-5-2-1.

Me 18.12.2024 AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 për shpërbllim me kontrat. OE LevelMax L.L.C, ndërsa me 10.01.2024 AK kapezulluar aktivitetin e prokurimit.

Me 23.12.2024 OE LevelMax L.L.C., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim. Më 31.12.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 10.01.2025, OE LevelMax L.L.C., ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 0036/2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rregullimi i varrezave të martirëve dhe dëshmoreve në fshatin Makovc-Ritender” me numër të prokurimit 616-24-12647-5-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se të dy ankesat i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këto ankesa sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesave në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues LevelMax L.L.C., janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi 1:

Në dosjen e tenderit, në kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare, siç kërkohet, kërkohet dëshmi:

Pas analizimit të dokumenteve të operatorit që është rekomanduar si fitues për këtë aktivitet nga autoriteti, shihet që ky operator nuk e plotëson këtë kërkesë, sepse nuk ka ofruar as deklaratat e dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës dhe as kopjet e raporteve financiare nga një firmë e njohur dhe e licencuar. Operatori i rekomanduar ka ofruar vetëm qarkullim bankar për këtë kërkesë, ndërkohë që me qarkullim bankar nuk plotësohet dëshmia e kërkuar më lart. Dëshmia (3 - Qarkullimi bankar) në ofertën e operatorit është dashur të çojë në përfundimin se ky operator është i papërgjegjshëm për këtë kriter, mirëpo, çuditërisht, kalon ky kriter pa u plotësuar fare. Me këtë rast, autoriteti ka bërë shkeljen e Ligjit me vetëdije, apo Nenet: 1, 6, 7, 10, 59, 60 dhe 64. Derisa kjo bie ndesh edhe me Deklaratën nën Betim të nënshkruar dhe vulosur nga vetë operatorit i rekomanduar.

Ndërsa, këtë dokument ne si GOE e kemi plotësuar në plotni, duke ofruar deklaratat e Administratës Tatimore, siç kërkoheshin.

Pretendimi 2:

Në dosjen e tenderit, në kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, pika 9.1 & 9.2, Kapaciteti teknik dhe profesional, kërkohen minimum 15 punëtorë, 1 menaxher i projektit, 1 inxhinier i ndërtimtarisë dhe 2 teknikë drejtimi ndërtimtari, siç kërkohet:

Pas analizimit të dokumenteve të operatorit që është rekomanduar si fitues për këtë aktivitet nga autoriteti, shihet që ky operator nuk e plotëson këtë kërkesë, sepse nuk ka ofruar stafin minimal të kërkuar. Përderisa, sipas dokumenteve që kemi marrë, ky operator ka ofruar vetëm 15 punëtorë nga 19 gjithsej që kërkoheshin, ndërkohë që ky operator është dashur të jetë i përgjegjshëm për këtë kriter, mirëpo çuditërisht kalon këtë kriter me vetëm 15 punëtorë në listën e stafit të ofruar. Dëshmi (5 - Lista e stafit) në ofertën e operatorit të rekomanduar nga autoriteti. Me këtë rast, autoriteti ka bërë shkeljen e Ligjit me vetëdije, apo Nenet: 1, 6, 7, 10, 59, 60 dhe 64. Derisa kjo bie ndesh edhe me Deklaratën nën Betim të nënshkruar dhe vulosur nga operatori i rekomanduar. Ndërsa, këtë kërkesë ne si GOE e kemi plotësuar në plotni, duke ofruar (15 punëtorë + 4 profesionistë), gjithsej 19 persona për aktivitetin.

Pretendimi 3:

Në dosjen e tenderit, në FDT, kërkesat e përshtatshmërisë, kërkohet:

Një dëshmi si Nr. 2, vertimi nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), nuk gjendet në dokumentet që pranuan nga autoriteti në ofertën e operatorit të rekomanduar për kontratë. Pra, para dhënies së kontratës, operatori është i obliguar të dorëzojë këtë vertetim nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), derisa me mosplotësimin e këtij kriteri është dashur të shpallet i përgjegjshëm si operator. Derisa kjo bie ndesh me Deklaratën nën Betim të nënshkruar dhe vulosur nga operatori i rekomanduar. Autoriteti, me këtë rast, ka bërë shkeljen e Ligjit me vetëdije, apo Nenet: 1, 6, 7, 10, 59, 60 dhe 64. Derisa kjo bie ndesh edhe me Deklaratën nën Betim të nënshkruar dhe vulosur nga operatori i rekomanduar.

Pretendimi 4:

Në dosjen e tenderit, në FDT, kërkesat e përshtatshmërisë, kërkohet vertetimet për pronar apo menaxhues, si dhe kërkohet vertetimi nga gjykata që kompania nuk është në falimentim, si në vijim:

Një dëshmi si, vertetimi nga gjykata për pronar dhe vertetimi nga gjykata për kompaninë, nuk gjendet në dokumentet që pranuan nga autoriteti në ofertën e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë. Pra, para dhënies së kontratës, operatori është i obliguar të dorëzojë këto vertetime të gjykatës, derisa me mosplotësimin e këtij kriteri është dashur të shpallet i përgjegjshëm si operator. Derisa kjo bie ndesh edhe me Deklaratën nën Betim të nënshkruar dhe vulosur nga operatori i rekomanduar. Autoriteti me këtë rast ka bërë shkeljen e Ligjit me vetëdije, apo Nenet: 1, 6, 7, 10, 59, 60 dhe 64. Derisa kjo bie ndesh edhe me Deklaratën nën Betim të nënshkruar dhe vulosur nga operatori i rekomanduar

Pretendimi 5:

Sa i përket pikës ku autoriteti na paraqet si ofertë jo të përgjegjshme lidhur me konsorciumin dhe liderin, kjo nuk qëndron, pasi të gjitha dokumentet tregojnë qartë se operatori *LevelMax L.L.C.* është caktuar si lider i grupit. Kjo është e vërtetuar në platformën E-Prokurimi dhe në dokumentin "Autorizimi i Liderit", i cili është pjesë e dokumentit "Themelimi i Grupit". Gabimi i emrit në dokumente, sipas Ligjit të Prokurimit Publik, është një "devijim i vogël", pasi

mbështetet nga të gjitha dokumentet e tjera, duke përfshirë dokumentin kryesor, "Autorizimi i Liderit të Grupit të Operatorëve Ekonomik" dhe dëshmitë e nënshkrimeve tek "Themelimi i Grupit".

Në këtë rast, autoriteti ka qenë i detyruar, sipas Ligjit të Prokurimit Publik, që në momentin kur kemi paraqitur makineritë në dokument dhe me fotografi, të kërkonte sqarime shtesë nga ne dhe jo të na vlerësonte menjëherë si operator të papërgjegjshëm. Nga ana tjetër, Komuna e Prishtinës ka shpallur fitues një operator që nuk plotëson dokumentet kryesore të kërkuara dhe gjithashtu ka paraqitur një çmim më të lartë se oferta jonë, prej 3,255.00 Euro.

Pretendimi 6:

Pretendimi i fundit është për mos përgjigjen nga AK për secilën pikë të ngritur nga ne si operatorë ekonomikë. Autoriteti kontraktues ka dhënë një vendim të përgjithësuar, që tregon se nuk e ka trajtuar kërkesën tonë si duhet.

Kërkojmë nga OSHP që lënda të kthehet në rivlerësim, të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK-së, ku gjatë procesit të rivlerësimit, të shpallemi fitues. Ndërkohë, operatori tjetër duhet të eliminohet, pasi është i papërgjegjshëm dhe ka paraqitur një çmim më të lartë prej 3,255.00 Euro.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim:

P.1. - Parashtruesi pretendon se tenderuesi i rekomanduar nuk ka dorëzuar as deklaratat tatimore dhe as raportet financiare por vetëm qarkullimin bankar prandaj nuk ka përmbushur kërkesën e DT lidhur me gjendjen ekonomike dhe financiare.

P.2. - Parashtruesi pretendon se tenderuesi i rekomanduar është dashur të prezentoj 19 punonjës mirëpo ka prezentuar vetëm 15 punëtor.

P.3. - Parashtruesi pretendon se tenderuesi i rekomanduar nuk ka dorëzuar aneksin 7 të plotësuar lidhur me afatin e implementimit dhe periudhën garantuese.

P.4. dhe P.5. - Parashtruesi pretendon se tenderuesi i rekomanduar nuk ka dorëzuar vërtetimin e ATK për borxhet, vërtetimin për falimentim dhe për të kaluarën penale.

P.6. - Ky pretendim i parashtruesit i referohet arsyes eliminuese nga AK ku përcaktohet se parashtruesi si lider të GOE ka përcaktuar OE Qëndrim Gubetini i cili nuk e plotëson kërkesën e DT për 60% të realizimit të kontratave në 3 vitet e fundit para njoftimit për kontratë. Parashtruesi pretendon se lider nuk është Qëndrim Gubetini por EevelMax.

P.7. - Ky pretendim i parashtruesit i referohet arsyes eliminuese nga AK ku përcaktohet se nuk janë dorëzuar me ofertë dëshmitë e kërkuara dokumentare lidhur me pajisjet. Parashtruesi pretendon se pajisjet i ka dorëzuar në listë ndërsa për dëshmitë dokumentare AK është dashur që të kërkoj sqarime shtesë.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit është gjetur se të gjitha pretendimet janë të pabazuara dhe në këtë rast i është faluar besimi i plotë vlerësimit të komisionit vlerësues pasi që argumentet e prezantuara nga parashtruesi nuk janë të bazuara. Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është

refuzuar si e pabazuar.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 21.01.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2025/0036. Lidhur me ankesen nr. 2025/0036 me datën 25.01.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që ky aktivitet i prokurimit të anulohet.

Raportin e ekspertizës me nr.0036/2025 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, si dhe OE nuk pajtohet rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertes shqyrtuese, parashtresat dhe dokumentet e ankuesve, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e LevelMax L.L.C., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0036 ka vlerësuar si në vijim:

Info për panelin;

Në bazë të analizimit të dosjes së tenderit si ekspert konstatoj se kriteret e vlerësimit nuk janë përputhje me LPP-ne pasi ka kërkuar kontrata të përhershëm për punëtoret profesional që si ekspert konstatoj se nuk është përputhjen me LPP-ne, gjithashtu edhe kërkesat tjera të dosjes së tenderit që kanë qenë konfuzë dhe me dy kuptime që në bazë të LPP-se duhet të jenë të qarta, gjithashtu kriteri i për dhënien e kontratës ka qenë tenderi ekonomikisht i favorshëm.

Si ekspert i prokurimit konstatoj se në bazë të LPP-se dhe kriterëve të dosjes së tenderit OE i rekomanduar nuk i plotëson kriteret e vlerësimit është i pa përgjegjshëm, ndërsa OE ankues nuk e plotëson Konzorciumin ka gabuar Emrin piken për caktimin e përgjegjësit kryesor – liderit e për këtë është eliminuar nga AK-ja e në bazë të kësaj konstatoj se duhet të anulohet ky aktivitet i prokurimit pasi nuk i plotësojnë kriteret që janë kërkuar në dosjen e tenderit.

Raportin fillestar ekspertizës së lartëcekur të datës 25.01.2025, PSH nuk e ka mbështetur ngase ka konsideruar se nuk është në pajtim me nenin 108/A, paragrafi 31.1 dhe 3.2 të LPP, po ashtu, në kundërshtim edhe me nenet 113 dhe 114 të LPP, pa nevojë që të përmenden edhe konstatimet e tij në kundërshtim edhe me Rregulloren për Prokurim Publik. Pasi që ankesa e paraqitur në këtë aktivitet të Prokurimit është kundër njoftimit për dhënie, ndërsa, eksperti shqyrtues hynë në shqyrtim të Njoftimit për kontratë/Dosjes së Tenderit përkatësisht në përcaktimin e kriterëve nga ana e AK, që fare nuk ka qenë

detyrë e tij.

Andaj, PSH konsideroi se lidhur me këtë rast k nevoj të bëhet një superekspertizë e cila duhet të jetë konform nenit 113 dhe 114 të LPP.

Pas autorizimit të ekspertit shqyrtues për super-ekspertizë për shqyrtimin e ankesës me numër 2025/036, nga ana e ekspertit janë analizuar pretendimet e ngritura përmes kësaj ankese, dhe nga shqyrtimi i tyre eksperti ka dhënë mendimin e tij dhe përgjigjet si më poshtë:

Pretendimi 1

OE ankues pretendon që: “Pas analizimit të dokumenteve të OE i rekomanduar shihet se ky operator nuk ka ofruar as Deklaratat e dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës dhe as Kopjet e raporteve financiare nga një firmë e njohur e licencuar. OE i rekomanduar ka ofruar Qarkullim Bankar e cila nuk plotëson dëshminë e kërkuar.”

Eksperti shqyrtues sqaron që një nga kërkesat e kapacitetit ekonomik dhe financiar ka qenë që operatorët ekonomik të dorëzojnë edhe deklaratat e dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës apo kopjet e raporteve financiare dhe raporteve të menaxhimit të certifikuar nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur. OE i rekomanduar në ofertën e tij ka dorëzuar Qarkullimin Bankar për periudhën 2021-2024, i cili dokument nuk përkon me kërkesën e parashtruar nga Autoriteti Kontraktues në dosjen e tenderit. Sipas nenit 59, pika 4 e LPP-së një tender mund të konsiderohet i përgjegjshëm vetëm në rastin kur i njëjti është në përputhje me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit. Andaj, ky dokument i dorëzuar sipas mendimit të ekspertit nuk përkon me kërkesat e FDT-së dhe se ky pretendim i ngritur nga ana e operatorit ankues konsiderohet që është i bazuar.

Pretendimi 2

“OE mik ka ofruar stafin minimal të kërkuar sipas DT-së. Sipas dokumenteve ky operator ka ofruar vetëm 15 punëtorë nga 19 gjithsejtë të kërkuar.”

Sa i përket këtij pretendimi të ngritur, eksperti sqaron se ka analizuar ofertën e operatorit të rekomanduar sa i përket kërkesës së dosjes së tenderit, ku nga operatorët pjesëmarrës është kërkuar që ndër të tjera të dorëzojnë edhe listën për staf, ku OE duhet të ketë minimumi 15 punëtorë dhe si dëshmi të dorëzohet lista e punëtorëve, përfshirë edhe stafin profesional. Në ofertën e OE të rekomanduar është dorëzuar lista e stafit me 15 punëtorë, prej të cilëve katër prej tyre janë staf profesional. Pra, në asnjë pikë të FDT-së nuk është cekur që përveç 15 punëtorëve duhet që AK të ketë edhe katër punëtorë të tjerë profesional, por sipas kërkesës së dosjes, i gjithë stafi është kërkuar që të jetë 15 punëtorë, andaj në këtë pikë konsiderohet që ky pretendim është i pabazuar.

Pretendimi 3

“Në DT është kërkuar që të plotësohet Aneksi 7 sa i përket afatit të implementimit të projektit dhe periudhës garantuese, ku OE i rekomanduar nuk ka ofruar fare këtë Aneks 7 në dokumentet e dorëzuara me ofertë.”

Eksperti pasqyron që në dosje të tenderit është kërkuar që të plotësohet Aneksi 7 i kësaj dosje, i cili përmban afatin e implementimit të projektit dhe periudhën garantuese, ku periudha garantuese është edhe

një nga kriteret e vendosura nga AK për zgjedhjen e tenderit të përgjegjshëm ekonomikisht më i favorshëm. OE i rekomanduar në ofertën e tij nuk ka dorëzuar Aneksin 7 sipas kërkesës së dosjes së tenderit, në të cilin ndër të tjera ka qenë edhe plotësimi i periudhës garantuese, e cila është një nga kriteret e dhënies së kontratës sipas Aneksit 6 të dosjes së tenderit. Pra, përveç që nuk është dorëzuar me ofertë Aneksi 7, AK nuk ka pasur mundësi se si të vlerësojë tenderin për kriterin e dhënies sa i përket garancionit të punimeve. Nga ana tjetër, OE ka dorëzuar Aneksin 6 të dosjes së tenderit, të vulosur dhe të nënshkruar duke ndërhyrë tek pjesa e koeficienteve për të shkruar të dhënat e operatorit sa i përket kriterëve të përcaktuara për dhënie, mirëpo mendimi i ekspertit shqyrtues është se ky Aneks i dorëzuar në vend të Aneksit 7 nuk e përmbush kërkesën e dosjes, sepse Aneksi 6 nuk është kërkuar që të ndryshohet, por ka qenë pjesë informuese për operatorët pjesëmarrës sa i përket kriterit të dhënies, ndërsa Aneksi 7 është dashur të plotësohet dhe të dorëzohet me ofertë sepse kjo ka qenë kërkesë e vet Autoritetit. Andaj, në këtë pikë vlerësohet që kjo kërkesë nuk është plotësuar nga ana e operatorit të rekomanduar dhe se pretendimi i ngritur është i bazuar.

Pretendimi 4

“Në FDT është kërkuar një vërtetim nga Administrata Tatimore e Kosovës para dhënies së kontratës, dhe OE është i obliguar të dorëzojë këtë vërtetim, i cili nuk gjendet në dokumentet e ofertës së operatorit të rekomanduar.”

Eksperti shqyrtues sqaron që sipas kërkesës së dosjes së tenderit dhe nenit 65 të LPP-së, në kërkesat e përshtatshmërisë kërkohet që para se operatori të propozohet për shpërblimin e kontratës dhe para publikimit të njoftimit mbi vendimin e AK-së, OE duhet të dorëzojë një vërtetim nga Administrata Tatimore e vendit se nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve deri në tre mujorin e fundit dhe një vërtetim nga Gjykata që vërteton që operatori, ndonjë drejtues apo menaxher i drejtor gjatë dhjetë viteve të fundit nuk kanë qenë të shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e ndonjë vepre penale apo nuk është në falimentim. Në sistemin e-prokurimi, pas ngritjes së këtij pretendimi, eksperti ka analizuar sistemin dhe ka parë që AK nuk ka bërë asnjë kërkesë për dorëzimin e dokumenteve të parapara me nenin 65 të LPP-së para se të shpallte operatorin e rekomanduar përmes Njoftimit mbi Vendimin e AK-së. Në këtë pikë konsiderohet që faji i mbetet autoritetit, i cili nuk ka bërë fare kërkesë për këtë pikë, sepse siç e parasheh ligji, kërkesa duhet të bëhet nga AK dhe në rastin se kjo kërkesë nuk përmbushet nga operatori, atëherë barra i bie atij, andaj në këtë pikë konsidëtohet që ky pretendim është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi 5

“Në FDT është kërkuar një vërtetim nga Gjykata për Pronarin dhe vërtetimi nga Gjykata për Kompaninë para dhënies së kontratës, ku OE është i obliguar të dorëzojë këtë vërtetim, i cili nuk gjendet në dokumentet e ofertës së operatorit të rekomanduar.”

Sqarimin e bërë në përgjigjen e pretendimit 4 eksperti sqaron që e njëjta përgjigje vlen edhe për këtë pretendim. Pra, është përgjegjësi e Autoritetit Kontraktues që të bëjë kërkesën për përmbushjen e kësaj kërkesë para se të publikohet njoftimi mbi vendimin e AK-së.

Pretendimi 6

“AK na ka paraqitur si ofertë të papërgjegjshme sa i përket pikës lidhur me liderin e konsorciumit. Një arsye e tillë nuk qëndron pasi që të gjitha dokumentet tregojnë qartë se operatori LevelMax L.L.C është

caktuar si Lider i Grupit. Gabimi i emrit në dokumente është devijim i vogël pasi që mbështetet nga të gjitha dokumentet e tjera, qoftë me Autorizimin e Liderit të Grupit, qoftë me Themelimin të Grupit.”

Eksperti shqyrtues sqaron që në dokumentet e dorëzuara me ofertën e OE ankues janë dorëzuar edhe dy dokumente, njëra prej të cilave është “Deklaratë për themelimin e grupit”, në të cilin deklarohet se partnerët konfirmojnë se kanë emëruar OE-Qendrim Gubetin si lider të grupit dhe dokumenti tjetër “Autorizimi i liderit të grupit të operatorëve ekonomik” përmes të cilit deklarohet se autorizohet OE-LevelMax L.L.C që të jetë lider dhe të veprojë në emër të grupit. Pra, këtu kemi të bëjmë me dy dokumente, ku në të dyja janë deklaruar dy lider të ndryshëm. Pretendimi i OE se ky ndryshim mund të merret si devijim i vogël duke u bazuar në nenin 59, pika 4 e LPP-së, sipas mendimit të ekspertit nuk qëndron, për arsye se kemi të bëjmë me dy dokumente të vlefshme ku nuk është aspak e qartë se cili nga operatorët është lideri i grupit, pra në rastin kur të dy dokumentet kanë të deklaruar dy liderë të ndryshëm nuk mund të merret asnjëri nga dokumentet si i vlefshëm dhe tjetri të konsiderohet si i pavlefshëm. Vlerësohet që ky pretendim i ngritur është i pabazuar.

Pretendimi 7

“Në rastin e makinerive ku kemi paraqitur makineritë në dokumente dhe me fotografi, AK është dashur që në bazë të LPP të kërkojë sqarime shtesë nga ne.”

Sa i përket këtij pretendimi të ngritur, eksperti ka analizuar ofertën e OE ankues dhe sqaron që në ofertën e OE ankues tek dokumenti (Pajisjet) janë dorëzuar disa fotografi për pajisjet e kërkuara dhe një librezë për kamionetë kiper. Sipas kërkesës së AK-së nga operatorët pjesëmarrës është kërkuar që të dorëzojnë edhe dëshmi për një kamion me kiper dhe dy makina për gdhendjen e gurit me gjylpon (automatike) dhe si dëshmi të dorëzohen librezat me validitet për pajisjen të cilat regjistrohen, ndërsa për ato të cilat nuk regjistrohen të dorëzohen deklaratat unike doganore apo faturat e blerjes si dhe marrëveshjet për manje me qera nëse OE nuk posedon në pronësi pajisjet.

Sipas mendimit të ekspertit, në rastin kur me ofertë janë dorëzuar fotografi të këtyre pajisjeve, vlerësohet që në bazë të nenit 72 të Ligjit për Prokurimin Publik, AK ka mundur të kërkojë sqarime shtesë për pajisjet e kërkuara, gjithmonë duke pasur parasysh që dëshmitë të cilat dorëzohen duhet të kenë një datë fikse para hapjes së ofertave dhe që kjo gjë të vërtetohet në mënyrë objektive. Konsiderohet që ky pretendim i ngritur është i bazuar.

Pretendimi 8

“Ky pretendim ka të bëjë me mos përgjigjen e AK në secilën pikë të ngritur në kërkesën për rishqyrtim, që tregon se nuk e ka trajtuar kërkesën tonë siç duhet.”

Në lidhje me këtë pretendim, eksperti sqaron që në Vendimin e lëshuar nga AK si përgjigje ndaj kërkesës për rishqyrtim, vlerësojmë që AK nuk ka vepruar në përputhje me nenin 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik, duke mos e arsyetuar refuzimin e kësaj kërkesë, pra duke mos u përgjigjur në pretendimet e ngritura nga OE ankues, por që AK vetëm deklaroi që i ka falur besimin vlerësimit të komisionit vlerësues dhe se të gjitha pretendimet janë të pabazuara pa arsyetim konkret. Andaj, konsiderohet që ky pretendim i ngritur është i bazuar.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që ky aktivitet i prokurimit duhet të anulohet.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e super ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues në super ekspertizë dhe mendimi i saj janë të pranueshme dhe se Paneli me të drejtë e mori në konsideratë me rastin e vendosjes pa nevojë që të njëjtat të përsëriten sërish.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues në super ekspertizë, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë të bazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues në super ekspertizë. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë pjesërisht të bazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik LevelMax L.L.C., të aprovohet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rregullimi i varrezave të martirëve dhe dëshmoreve në fshatin Makovc-Ritender” me numër të prokurimit 616-24-12647-5-2-1, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe aktiviteti i prokurimit duhet të anulohet ne tersi. Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik e sheh si pjesërisht të bazuar, por që përshkak të mangësive të mëdha aktiviteti i prokurimit ne fjalë anulohet.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të anulohet.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale-Departamenti Administratë në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - LevelMax L.L.C.**
- Arkivës së OSHP-së: